

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Siguria kombëtare, ekonomia dhe sektorët kritikë

Vlerësim për Objektivat II dhe III në 6 muajt e parë të zbatimit.



BIRN

Balkan
Investigative
Reporting
Network

ALBANIA

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Siguria kombëtare, ekonomia
dhe sektorët kritikë

Vlerësim për Objektivat II dhe III në 6 muajt e parë të zbatimit

Mars 2026

Botuar nga: Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri

Rruga Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri

<http://birn.eu.com/>

Autor: Alban Dafa

© 2026 Balkan Investigative Reporting Network Albania (BIRN Albania)



Versioni elektronik i këtij botimi është i disponueshëm nën licencën Creative Commons Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0. Ju mund ta kopjoni, shpërndani dhe transmetoni botimin, si dhe ta rimodeloni apo përshtasni, me kusht që përdorimi të jetë vetëm jofitimprurës, që t'i atribuoni në mënyrë të duhur botimit dhe që ta shpërndani nën të njëjtën licencë. Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare të Creative Commons: <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>.

Ky raport është hartuar për BIRN Albania me mbështetjen e FCDO nëpërmjet Ambasadës Britanike në Tiranë. Gjetjet e këtij raporti janë përgjegjësi e vetme e autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmëri ato të Ambasadës Britanike në Tiranë.



PËRMBAJTJA

	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1.	KONTEKSTI	9
2.	QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT	11
3.	VLERËSIMI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE II DHE II TË STRATEGJISË	16
	3.1 Masat e parashikuara në Objektivat II dhe III të Strategjisë	17
	3.2 Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë	18
	3.3 Statusi i zbatimit të masave	20
	3.3.1 Objektivi II: Mbrojtja e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse	21
	3.3.2 Objektivi III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve të tjerë kritikë	26
4.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	33
	Rekomandime për Objektivin II:	34
	Rekomandime për Objektivin III:	35

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Tipologjia e masave të parashikuara në Strategji	17
Figura 2: Numri i masave sipas institucionit përgjegjës	19
Figura 3: Shpërndarja e masave sipas statusit të zbatimit	21

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Tipologjia e masave të monitoruara sipas natyrës së ndërhyrjes	14
Tabela 2: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit II – Fusha 1	23
Tabela 3: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit II – Fusha 2	26
Tabela 4: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit III – Fusha 1	30
Tabela 5: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit III – Fusha 2	32

Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 synon të forcojë reziliencën institucionale të Shqipërisë ndaj ndërhyrjeve hibride, duke adresuar jo vetëm manipulimin e informacionit, por edhe rreziqet që lidhen me sigurinë kombëtare, sektorët strategjikë të ekonomisë dhe ndikimet keqdashëse përmes investimeve apo varësive strukturore ekonomike. Ky raport vlerëson progresin e gjashtë muajve të parë të zbatimit të Objektivit II dhe Objektivit III të Strategjisë, të cilët lidhen respektivisht me mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe me rritjen e reziliencës së ekonomisë dhe sektorëve kritikë.

Gjetja kryesore e monitorimit është se zbatimi i këtyre objektivave mbetet në një fazë fillestare dhe i varur në mënyrë të konsiderueshme nga zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe institucional. Nga 16 masat e analizuara, asnjë nuk rezultoi e zbatuar plotësisht, ndërsa 62% e tyre nuk kanë hyrë ende në fazë zbatimi ose nuk shoqërohen me informacion të mjaftueshëm publik për të vlerësuar progresin. Vetëm 38% e masave rezultojnë në faza fillestare zbatimi, kryesisht në formën e veprimeve përgatitore dhe koordinuese institucionale.

Progresi i vërejtur lidhet kryesisht me masa që mbështeten në instrumente ekzistuese strategjike dhe rregullatore, veçanërisht në fushën e monitorimit të investimeve të huaja, transparencës së flukseve financiare dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në sektorin bankar dhe financiar. Megjithatë, një pjesë e këtyre zhvillimeve nuk burojnë drejtpërdrejt nga zbatimi i Strategjisë, por nga procese të tjera reformuese në kuadër të përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian dhe dokumenteve të tjera strategjike kombëtare.

Në fushën e sigurisë kombëtare dhe reagimit ndaj ndërhyrjeve hibride, raporti evidenton mungesën e zhvillimeve konkrete në disa prej masave kyçe të Strategjisë, përfshirë hartimin e një kuadri ligjor të posaçëm për ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin, krijimin e Strukturës Përgjegjëse për koordinimin ndërinstitucional dhe ngritjen e një mekanizmi të përhershëm parlamentar për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë. Mungesa e këtyre elementeve ka ndikuar drejtpërdrejt në ritmin e kufizuar të progresit dhe ka krijuar paqartësi në shpërndarjen e përgjegjësive institucionale.

Në dimensionin ekonomik dhe të sektorëve strategjikë, Strategjia parashikon krijimin e një kuadri rregullator për shqyrtimin e investimeve të huaja dhe monitorimin e varësive nga furnitorë me risk, si dhe forcimin e transparencës mbi flukset financiare dhe pronësinë përfituese. Megjithëse janë ndërmarrë disa hapa në këtë drejtim, përfshirë iniciativa për përafrimin me Rregulloren (BE) 2019/452 për kontrollin e investimeve të huaja direkte, mungon ende një arkitekturë e plotë ligjore dhe institucionale që të mundësojë një qasje të koordinuar kombëtare për mbrojtjen e sektorëve kritikë.

Raporti evidenton gjithashtu se një pjesë e masave të Strategjisë karakterizohen nga një nivel relativisht i lartë përgjithësie dhe nga mungesa e përcaktimeve të qarta mbi përgjegjësitë institucionale dhe hapat konkretë të zbatimit. Në disa raste, kjo ka krijuar mbivendosje me mekanizma ekzistues institucionalë ose paqartësi mbi rolin e institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masave specifike.

Gjetjet e këtij monitorimi sugjerojnë se progresi i mëtejshëm në zbatimin e Objektivave II dhe III do të varet në mënyrë vendimtare nga miratimi i Planit të Veprimit për Strategjinë, krijimi i strukturës koordinuese të parashikuar dhe avancimi i kuadrit ligjor për adresimin e ndërhyrjeve hibride dhe mbrojtjen e sektorëve strategjikë të ekonomisë. Në mungesë të këtyre elementeve, ekziston rreziku që Strategjia të mbetet një kornizë orientuese politike pa instrumentet e nevojshme operationale për zbatimin efektiv të saj.

1.KONTEKSTI

Gjatë dekadës së fundit, ndërhyrjet nga entitete të huaja keqdashëse janë kthyer në një kërcënim serioz për stabilitetin e demokracisë shqiptare, sigurinë kombëtare të vendit, si dhe zhvillimin e tij ekonomik të qëndrueshëm. Edhe pse këto fenomene kanë përmasa globale, statusi i Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian e vendos atë në një kontekst të qartë gjeopolitik perëndimor, ku stabiliteti institucional dhe ekonomik sfidohen gjithnjë e më shumë nga ndërhyrjet hibride të aktorëve rivalë.

Për t'iu përgjigjur këtyre kërcënimeve, në shkurt 2024 Kuvendi i Shqipërisë ngriti një Komision të Posaçëm për Luftën kundër Dezinformimit. Produkt i punës njëvjeçare të këtij komisioni, në bashkëpunim me institucionet e sigurisë kombëtare dhe aktorë të shoqërisë civile, ishte hartimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, e miratuar në korrik 2025. Ky dokument përcakton drejtimit strategjike të shtetit shqiptar për parandalimin, identifikimin dhe adresimin e ndërhyrjeve të huaja në fusha të ndryshme me rëndësi për funksionimin e institucioneve demokratike dhe sigurinë e vendit.

Strategjia synon të garantojë mbrojtjen e institucioneve dhe proceseve demokratike nga ndërhyrjet e koordinuara nga aktorë të huaj, të cilat shfaqen përmes instrumenteve të ndryshme hibride, përfshirë manipulimin e informacionit, presionet ekonomike, ndërhyrjet në sektorë strategjikë dhe sulmet kibernetike. Këto ndërhyrje rrezikojnë të minojnë besimin tek institucionet publike, stabilitetin ekonomik dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër, Strategjia parashikon katër objektiva kryesorë që adresojnë dimensione të ndryshme të fenomenit. Ky raport fokusohet në vlerësimin e progresit fillestar të zbatimit të Objektivit II dhe Objektivit III, të cilët lidhen respektivisht me forcimin e kapaciteteve për mbrojtjen e sigurisë kombëtare ndaj ndërhyrjeve hibride dhe me rritjen e reziliencës së ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë ndaj ndikimeve keqdashëse nga aktorë të huaj.

Objektivi II synon forcimin e kapaciteteve për zbulimin e hershëm, identifikimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve hibride, përmes përmirësimit të koordinimit ndërinstytucional, mbrojtjes së infrastrukturës kritike, zhvillimit të komunikimit strategjik me publikun, forcimit të kapaciteteve kibernetike dhe zgjerimit të bashkëpunimit me sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Ndërkohë, **Objektivi III** ka për qëllim mbrojtjen e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë nga ndërhyrjet e huaja përmes forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të kapitaleve në ekonomi, adresimit të rreziqeve që lidhen me investimet në sektorë kritikë dhe rritjes së kapaciteteve institucionale për parandalimin e ndikimeve keqdashëse në sistemin financiar dhe infrastrukturën strategjike të vendit.

2. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Ky raport përqendrohet në vlerësimin e progresit fillestar të zbatimit të Objektivit II dhe Objektivit III të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 gjatë gjashtëmuajorit të parë të zbatimit të saj. Në mënyrë të veçantë, analiza shqyrton hapat e ndërmarrë për forcimin e kapaciteteve të sigurisë kombëtare për identifikimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve hibride, mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe zhvillimin e komunikimit strategjik, si dhe masat që lidhen me mbrojtjen e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse.

Objektivat I dhe IV trajtohen në një raport të veçantë monitorimi, i cili fokusohet në dimensionin zgjedhor, lirinë e medias dhe ndërgjegjësimin publik.

Vlerësimi mbulon periudhën korrik 2025 – fillim janari 2026 dhe fokusohet në hapat fillestarë institucionalë dhe progresin në krijimin e mekanizmave të zbatimit. Ai nuk synon të masë ndikimin afatgjatë të Strategjisë në mjedisin informativ, në reziliencën institucionale apo në qëndrueshmërinë demokratike, por të evidentojë nivelin aktual të përgatitjes institucionale për zbatimin e masave të parashikuara.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një vlerësim të ecurisë së zbatimit të masave të parashikuara në Strategji, si dhe të analizojë nivelin e zhvillimit të infrastrukturës institucionale për zbatimin e tyre gjatë gjashtë muajve të parë pas miratimit të saj.

Raporti vlerëson zbatimin e 16 masave të parashikuara në dy nga katër objektivat e Strategjisë:

- Objektivit II: Mbrojtja e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse
- Objektivit III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë

Ky raport bazohet në një metodologji monitorimi të strukturuar, e cila synon të vlerësojë progresin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit për Objektivat II dhe III përmes analizimit të dokumenteve institucionale, vlerësimin cilësor dhe verifikimit empirik të të dhënave të disponueshme.

Njësia kryesore e vlerësimit janë masat e parashikuara në Strategji dhe në Udhërrëfyesin përkatës. Këto masa janë organizuar sipas objektivave strategjikë dhe fushave tematike, duke mundësuar një analizë të strukturuar të ndërhyrjeve në nivel politikash publike. Për çdo masë është ndërtuar një matricë standarde vlerësimi, e cila përfshin pesë dimensione kryesore:

- qartësinë e masës
- harmonizimin me dokumente të tjera strategjike kombëtare
- statusin e zbatimit
- rezultatet e arritura
- nivelin e transparencës institucionale





Qartësia e masës vlerëson nëse janë të përcaktuara në mënyrë të saktë qëllimet, veprimet konkrete dhe institucionet përgjegjëse. Harmonizimi analizon lidhjen e masës me dokumente të tjera strategjike, si Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2024 dhe Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030, për të vlerësuar nivelin e koherencës ndërsektoriale të politikave publike në këtë fushë.

Statusi i zbatimit klasifikohet në kategori të qarta: “e pazbatuar”, “në zbatim” apo “e përmbushur pjesërisht”, duke reflektuar progresin aktual institucional. Ndërkohë, dimensionin e rezultateve synon të identifikojë nëse masat kanë prodhuar rezultate të verifikueshme në fazën fillestare të zbatimit, ndërsa transparencja vlerëson nëse institucionet kanë bërë publike informacionet mbi progresin e tyre.

Metodologjia nuk kufizohet në një vlerësim formal të statusit të masave, por përfshin edhe analizën e ndërvarësisë midis tyre. Në shumë raste, moszbatimi i masave kyçe, si mungesa e kuadrit ligjor përkatës apo e strukturave përgjegjëse, ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të zbatuar masa të tjera të lidhura. Ky dimension mundëson identifikimin e pengesave strukturore në procesin e zbatimit dhe jo vetëm të vonësive administrative.

Përveç vlerësimit sipas dimensioneve të mësipërme, masat e monitoruara janë klasifikuar edhe sipas tipologjisë së ndërhyrjes së parashikuar në Strategji. Ky klasifikim mundëson një analizë më të qartë të progresit sipas natyrës së masave – ligjore, institucionale, operacionale dhe të ndërgjegjësimit publik – dhe ndihmon në identifikimin e fushave ku progresi rezulton më i kufizuar, siç paraqitet në Tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1: Tipologjia e masave të monitoruara sipas natyrës së ndërhyrjes

Masat	Treguesit kryesorë
<p>Masa ligjore dhe rregullatore</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i një kuadri rregullator për shqyrtimin dhe kontrollin e investimeve të huaja (mekanizmi i shqyrtimit të investimeve – MSHI) • Përmirësimi i kuadrit ligjor për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonomi • Vendosja e standardeve dhe rregullave për mbrojtjen e sektorëve strategjikë dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurt • Forcimi i kuadrit ligjor për transparencën dhe mbikëqyrjen e investimeve dhe flukseve financiare
<p>Masa institucionale</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për sigurinë kombëtare dhe ekonomike • Forcimi i kapaciteteve të institucioneve publike dhe private që administrojnë infrastrukturën kritike • Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe adresimin e dobësive në sistemet kritike • Forcimi i rolit të institucioneve financiare dhe rregullatore në monitorimin e rreziqeve ekonomike
<p>Masa operacionale dhe koordinuese</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve të tjerë • Ndërtimi i një sistemi të komunikimit strategjik për informim të shpejtë dhe të besueshëm të publikut • Kryerja e testeve dhe simulimeve për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve hibride në infrastrukturë • Organizimi i stërvitjeve kombëtare dhe ndërkombëtare për reagim ndaj kërcënimeve hibride • Forcimi i bashkëpunimit me sektorin privat, median dhe shoqërinë civile • Rritja e bashkëpunimit me NATO dhe BE për identifikimin dhe kundërshtimin e ndërhyrjeve hibride • Mbështetja e solidaritetit dhe koordinimit ndërkombëtar për reagim ndaj kërcënimeve
<p>Masa të ndërgjegjësimit dhe edukimit</p> 	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i komunikimit publik mbi rreziqet ekonomike dhe financiare që lidhen me ndërhyrjet e huaja • Rritja e transparencës për publikun mbi investimet dhe aktivitetet ekonomike strategjike • Promovimi i informimit të besueshëm për të reduktuar ndikimin e dezinformimit në sektorin ekonomik • Nxitja e bashkëpunimit me median dhe aktorët publikë për të rritur ndërgjegjësimin mbi kërcënimet hibride

Burimet e të dhënave përfshijnë dokumente zyrtare (ligje, strategji, projektakte), informacione të siguruar nga institucionet publike përmes kërkesave për informacion, si dhe materiale të publikuara nga institucione përgjegjëse për sektorë specifikë, përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe agjenci të tjera shtetërore. Në rastet kur mungon informacioni zyrtar ose ai është i paplotë, kjo evidentohet si problem i transparencës institucionale dhe merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar.

Një element i rëndësishëm i metodologjisë është vlerësimi kritik cilësor. Përtej tabelave sintetike të statusit të masave, raporti analizon përmbajtjen e tyre, identifikon paqartësitë konceptuale, boshllëqet ligjore dhe risqet potenciale në zbatim – përfshirë edhe rreziqet për cenimin e lirive themelore apo për ndërhyrje të panevojshme institucionale.

Metodologjia synon gjithashtu të evidentojë boshllëqet sistemike në procesin e raportimit dhe monitorimit institucional, përfshirë mungesën e metodologjive të standardizuara për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave, si dhe sfidat që lidhen me koordinimin ndërinstitutional në zbatimin e Strategjisë.

Vlerësimi është zhvilluar në kushtet e mungesës së një Plani të Veprimit të miratuar për zbatimin e Strategjisë, çka ka ndikuar në nivelin e disponueshmërisë së informacionit institucional dhe në interpretimin e statusit të disa masave nga institucionet përgjegjëse.

3. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE II DHE III TË STRATEGJISË

3.1 Masat e parashikuara në Objektivat II dhe III të Strategjisë

3.2 Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë

3.3 Statusi i zbatimit të masave

Ky kapitull paraqet vlerësimin e progresit fillestar të zbatimit të masave të parashikuara në kuadër të Objektivit II dhe Objektivit III të Strategjisë gjatë periudhës korrik 2025 – fillim janari 2026, duke analizuar zhvillimet institucionale, ligjore dhe operacionale që lidhen me forcimin e kapaciteteve për reagim ndaj ndërhyrjeve hibride dhe mbrojtjen e sektorëve strategjikë të ekonomisë kombëtare.

3.1 Masat e parashikuara në Objektivat II dhe III të Strategjisë

Në kuadër të Objektivit II dhe Objektivit III të Strategjisë janë parashikuar gjithsej 16 masa, prej të cilave 10 masa në Objektivin II (7 në fushën e parë dhe 3 në fushën e dytë) dhe 6 masa në Objektivin III (4 në fushën e parë dhe 2 në fushën e dytë). Afatet e zbatimit të këtyre masave janë të ndara në disa kategori: një pjesë e tyre kanë afate të përcaktuara kohore konkrete, kryesisht brenda periudhës 2025–2026, veçanërisht ato që lidhen me hartimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e strukturave institucionale; një pjesë tjetër janë parashikuar si masa në vijimësi, që nënkupton zbatim të vazhdueshëm pa një afat përfundimtar të qartë; ndërsa disa masa kanë karakter periodik, si raportimet e rregullta institucionale apo aktivitetet e monitorimit dhe informimit publik.

Tipologjia e masave në këto dy objektiva reflekton një qasje të ndërthurur midis ndërhyrjeve ligjore, institucionale, operacionale dhe të ndërgjegjësimit publik. Në mënyrë më të detajuar, masat mund të klasifikohen në katër kategori kryesore: (i) masa ligjore dhe rregullatore, që synojnë krijimin ose përmirësimin e kuadrit normativ për adresimin e ndërhyrjeve të huaja dhe mbrojtjen e sektorëve strategjikë; (ii) masa institucionale, që parashikojnë ngritjen ose forcimin e strukturave dhe mekanizmave mbikëqyrës; (iii) masa operacionale dhe koordinuese, që lidhen me bashkëpunimin ndërinstytucional, shkëmbimin e informacionit dhe monitorimin e sektorëve kritikë; si dhe (iv) masa të ndërgjegjësimit dhe edukimit publik, që synojnë rritjen e reziliencës ndaj dezinformimit dhe ndërhyrjeve hibride (shih Figurën 1).

Figura 1: Tipologjia e masave të parashikuara në Strategji

Masa operacionale dhe koordinuese	Masa të ndërgjegjësimit dhe edukimit	Masa ligjore/ rregullatore
		Masa institucionale
9	3	2

Masat e parashikuara në kuadër të Objektivit II përqendrohen kryesisht në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për përballjen me ndërhyrjet e huaja hibride, si dhe në zhvillimin e mekanizmave të koordinimit ndër-institucional dhe komunikimit strategjik me publikun. Në këtë drejtim, Strategjia parashikon ndër të tjera hartimin e një ligji të posaçëm në këtë fushë, ngritjen e një strukture të dedikuar kombëtare, forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe mbikëqyrjes parlamentare, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit me median dhe aktorët e verifikimit të fakteve. Paralelisht, një grup masash synon rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe zhvillimin e politikave për edukimin mediatik, përmes hartimit të dokumenteve strategjike dhe organizimit të aktiviteteve informuese dhe edukative.

Ndërkohë, masat e parashikuara në kuadër të Objektivit III fokusohen në forcimin e mbrojtjes së ekonomisë kombëtare dhe sektorëve strategjikë nga ndërhyrjet e huaja përmes një kombinimi masash ligjore, institucionale dhe bashkëpunuese. Këto përfshijnë krijimin e një kuadri rregullator për shqyrtimin e investimeve të huaja, ngritjen e mekanizmave për monitorimin e sektorëve strategjikë dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë me risk, si dhe forcimin e kapaciteteve për identifikimin dhe adresimin e dezinformimit në sektorin financiar. Paralelisht, Strategjia parashikon rritjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat, si dhe përmirësimin e transparencës publike mbi investimet dhe flukset financiare me rëndësi strategjike.

Në tërësi, masat e parashikuara në këto dy objektiva synojnë ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për forcimin e reziliencës së sigurisë kombëtare dhe ekonomike ndaj ndërhyrjeve të huaja, por karakterizohen nga një nivel relativisht i lartë përgjithësie dhe nga një varësi e konsiderueshme nga zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor dhe institucional për zbatimin e tyre efektiv.

3.2 Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë

Kuadri institucional për zbatimin dhe mbikëqyrjen e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 mbështetet në një kombinim mekanizmesh parlamentarë, ekzekutivë dhe sektorialë, të cilët parashikohen të bashkëpunojnë për zbatimin e masave të përcaktuara në Objektivat II dhe III.

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për të koordinuar dhe mbikëqyrur të gjitha veprimet institucionale për të luftuar dezinformimin dhe format e tjera të ndërhyrjes së huaj në proceset demokratike të vendit” e ushtroi funksionin e tij deri në përfundim të Legjislaturës së X-të të Kuvendit të Shqipërisë. Mandati i këtij komisioni u mbyll me shqyrtimin dhe miratimin e Ligjit Nr. 47/2025 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030”.

Në legjislaturën aktuale të Kuvendit të Shqipërisë nuk është parashikuar ngritja e një komisioni të posaçëm për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin. Si pasojë, evidentohet një boshllëk


institucional në aspektin e mbikëqyrjes parlamentare të specializuar për zbatimin e Strategjisë, si dhe paqartësi mbi strukturat përgjegjëse që do të ushtrjnë funksionin e monitorimit të progresit të saj.

Strategjia ngarkon Këshillin e Ministrave me hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e saj brenda vitit 2025, si dhe me sigurimin e mbështetjes buxhetore për masat dhe investimet e parashikuara. Njëkohësisht, Strategjia parashikon krijimin e një strukture të dedikuar për evidentimin dhe përballjen me ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin, e cila pritet të luajë rol koordinues ndërinstitutional dhe të mbajë përgjegjësi të drejtpërdrejta për zbatimin e një pjese të konsiderueshme të masave, veçanërisht në kuadër të Objektivave II dhe III.

Megjithatë, deri në momentin e publikimit të këtij raporti, Plani i Veprimit nuk është miratuar dhe struktura e dedikuar nuk është krijuar apo përcaktuar. Mungesa e këtyre elementeve themelore të arkitekturës së zbatimit ka ndikuar në ritmin e fillimit të zbatimit të masave dhe ka krijuar pasiguri mbi përgjegjësitë institucionale në disa prej fushave të ndërhyrjes së Strategjisë.

Shpërndarja e masave në kuadër të Objektivave II dhe III reflekton një arkitekturë institucionale të shpërndarë ndërmjet institucioneve politike, rregullatore, financiare dhe teknike. Në këtë strukturë, “Struktura përgjegjëse” e parashikuar nga Strategjia pritet të luajë rolin kryesor koordinues, ndërsa Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë mbajnë rol qendror në hartimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrjen e zbatimit. Paralelisht, institucione sektoriale si Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe agjenci të tjera teknike kontribuojnë në monitorimin dhe zbatimin praktik të masave në sektorët përkatës (shih Figurën 2).

Figura 2: Numri i masave sipas institucionit përgjegjës



Në mungesë të strukturës koordinuese të parashikuar dhe të Planit të Veprimit të miratuar, ekziston rreziku që shpërndarja e përgjegjësive ndërmjet institucioneve të mbetet fragmentare dhe e paqartë, duke kufizuar efektivitetin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional dhe të mbikëqyrjes parlamentare dhe ekzekutive të zbatimit të Strategjisë në këtë fazë fillestare.

3.3 Statusi i zbatimit të masave

Nga analiza e të dhënave për 16 masat e parashikuara në kuadër të Objektivave II dhe III të Strategjisë (shih Tabelën 1 dhe Tabelën 2), rezulton se për pjesën më të madhe të tyre nuk ka nisur ende zbatimi ose nuk ka informacion të mjaftueshëm publik për të vlerësuar progresin konkret. Në total, 10 masa, që përbëjnë 62% të masave të analizuara, klasifikohen në këtë kategori. Ndërkohë, 6 masa, ose 38% e tyre, rezultojnë në faza fillestare zbatimi, kryesisht në formën e veprimeve përgatitore, koordinuese ose të planifikimit institucional (shih Figurën 3).

Në periudhën e monitorimit nuk evidentohet asnjë masë e zbatuar plotësisht. Ky rezultat reflekton faktin se një pjesë e konsiderueshme e masave të parashikuara në këta dy objektiva janë të varura nga miratimi i kuadrit ligjor përkatës, krijimi i strukturave të dedikuara institucionale dhe miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë, të cilat deri në momentin e publikimit të këtij raporti nuk janë finalizuar.

Në tërësi, shpërndarja e statusit të zbatimit tregon se progresi i deritanishëm mbetet i përqendruar kryesisht në fazat fillestare të organizimit institucional dhe koordinimit ndërinstitucional, ndërsa masat me karakter rregullator, strukturor dhe operativ nuk kanë hyrë ende në faza të avancuara zbatimi.





-  → Nuk ka nisur zbatimi/nuk ka informacion (10 nga 16 ose 62%)
-  → Në fazë fillestare zbatimi (6 nga 16 ose 38%)
-  → E zbatuar (0 nga 16 ose 0%)

Figura 3: Shpërndarja e masave sipas statusit të zbatimit



3.3.1 Objektivi II: Mbrojtja e sigurisë kombëtare nga ndërhyrjet e huaja keqdashëse

Objektivi II përmban një sërë zotimesh dhe masash, të cilat rrjedhin prej trajtimit të luftës hibride në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK) 2024¹ dhe qëllimeve politike të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030.²

Zotimet dhe masat janë të organizuara në dy fusha: (1) përmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim dhe (2) ndërgjegjësimi publik mbi instrumentat e ndërhyrjeve dhe rritja e edukimit publik mbi dezinformimin.

Objektivi përmban një sërë shprehjesh deklarative, ndër të tjera, për forcimin e aftësisë për të zbuluar hershëm dhe për të reaguar ndaj aktiviteteve hibride armiqësore, forcimin e aftësisë për të identifikuar dobësitë dhe për të kuptuar pasojat e ndërhyrjeve hibride, rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional, si dhe rritjen e bashkëpunimit me sektorin privat, median, organizatat jo-fitimprurëse dhe me sistemin arsimor.

Mirëpo, duke qenë të përgjithshme dhe deklarative, ato nuk shprehin qartë se cilat janë nevojat specifike për t'iu përballur kërcënimeve hibride në Shqipëri. Mungesa e kësaj qartësie është

¹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2024, <https://www.mod.gov.al/images/PDF/2024/strategjia-kombetare-2024.pdf>.

² Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030, <https://aksk.gov.al/wp-content/uploads/2025/10/Strategjia-Kombetare-per-Sigurine-Kibernetike-2025-2030.pdf>.

reflektuar në mungesën e qartësisë së synimit të masave specifike dhe përgjegjësiwe institucionale për realizimin e tyre. Përpos këtyre problematikave strukturore, Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshme për hartimin e një ligji për ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin, ndërkohë që Këshilli i Ministrave nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për përballjen me përpjekjet për ndërhyrje keqdashëse dhe dezinformim. Mungesa e këtyre dy masave kyçe ka ndikuar negativisht në zbatimin e masave të tjera të këtij objekti.

Fusha 1: Pëmirësimi i kuadrit ligjor dhe forcimi i kapaciteteve institucionale në evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim

Kjo fushë përmban shtatë masa. Njëra prej tyre parashikon hartimin e ligjit për të përcaktuar fushën e veprimtarisë në lidhje me parandalimin e ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimin dhe për të qartësuar përgjegjësitë institucionale (**Masa 2.1.1**). Të ndërlidhura me këtë masë ligjore janë dy masa institucionale: njëra për ngritjen e Strukturës Përgjegjëse (**Masa 2.1.2**), e cila duhet të ketë rolin kryesor në koordinimin e përgjigjeve institucionale ndaj përpjekjeve për ndërhyrje dhe dezinformim, dhe tjetra për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e koordinimit ndërinstitutional (**Masa 2.1.3**). Ndërkohë, prej katër masave që mbeten, dy prej tyre janë të lidhura me nevojën për ngritjen e një komisioni të përhershëm parlamentar (**Masa 2.1.4** dhe **Masa 2.1.5**) për ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin dhe dy të tjerat synojnë rritjen e bashkëpunimit midis institucioneve dhe mediave për verifikimin e vërtetësisë së informacionit, si dhe për vetërregullimin dhe bashkërregullimin e medias (**Masa 2.1.6** dhe **Masa 2.1.7**).

Vlen të ritheksohet se të shtata këto masa mbeten të pazbatuara, ndërkohë që duhet të ishin zbatuar brenda dhjetorit të vitit 2025, sipas përcaktimeve të Udhërrëfyesit të Strategjisë. Ndërkohë, komisioni i përhershëm parlamentar duhet të ishte ngritur brenda tetorit të vitit 2025. Përveç dy masave të lidhura me ngritjen e komisionit të përhershëm parlamentar, zbatimi i masave të tjera lidhet me hartimin e ligjit dhe ngritjen e Strukturës Përgjegjëse. Moszbatimi i këtyre masave ndikon negativisht në zbatimin e masave të tjera, pasi Struktura Përgjegjëse është institucioni përgjegjës për zbatimin e katër prej shtatë masave.





Ndonëse masat janë në tërësi të ndërthurura me disa prej qëllimeve politike të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, ato kanë nevojë të qartësohen si në aspektin e qëllimeve fundore që synojnë ashtu edhe në aspektin e përgjegjësiwe institucionale.

Problematike janë sidomos masa që synon rritjen e bashkëpunimit midis institucioneve dhe mediave për verifikimin e vërtetësisë së informacionit dhe ajo për vetërregullimin dhe bashkërregullimin e medias. Të dyja këto masa nuk kanë të parashikuara një renditje të veprimeve përkatëse që duhet të merren për zbatimin e tyre, çka e bën të vështirë dhe mundësisht të dëmshëm zbatimin e tyre

në mungesë të qartësisë së qëllimit të këtyre politikave. Në rastin e parë, risqet e ndërhyrjes së institucioneve publike për të censuruar informacionin me pretekstin e dezinformimit janë të larta dhe është e nevojshme të krijohen mekanizmat e nevojshme ligjore për të parandaluar abuzime të mundshme. Risqe të ngjashme vihen re edhe në zbatimin e masës për të bashkërregulluar dhe vetërregulluar. Edhe në këtë rast nuk janë të parashikuara veprimet specifike, ndërkohë që duhet qartësuar se çfarë nënkuptohet me termat “bashkërregullim” dhe “vetërregullim” pasi në pamje të parë duken në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Tabela 2: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit II – Fusha 1

Masa	Qartësia	Harmonizimi	Zbatimi	Rezultatet e zbatimit
2.1.1 Hartimi i një akti ligjor mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin	Masa dhe institucionet përgjegjëse janë të qarta.	SSK 2024 SKSK 2025-2030		Të papërbushur
2.1.2 Krijimi i një strukture të veçantë për evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim (“Struktura Përgjegjëse”)	Është e paqartë nëse institucioni do ketë detyra hulumtuese, politikëbërëse, zbatuese të politikave, apo të gjitha bashkë. Koordinimi ndërinstytucional është i paqartë të secilit institucion janë të paqarta.	SSK 2024 SKSK 2025-2030		Të papërbushur
2.1.3 Koodinimi ndërinstytucional dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për evidentimin dhe përballjen me përpjekjet për ndërhyrje dhe dezinformim	Është e paqartë se çfarë duhet të përmbajë rrjeti i komunikimit përtej përcaktimit të kontakteve institucionale dhe se si duhet të kryhet koordinimi ndërinstytucional.	SSK 2024 SKSK 2025-2030		Të papërbushur. Struktura e Posaçme nuk është ngritur.

<p>2.1.4 Komisioni i përhershëm parlamentar për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin</p>	<p>Masa dhe institucioni përgjegjës janë të qartë.</p>	<p>Komisioni i Përkohshëm Parlamentar</p>		<p>Të papërbushur</p>
<p>2.1.5 Raportimi periodik në Komision Parlamentar nga struktura që do të krijohet për zbulimin, analizimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse dhe dezinformimit</p>	<p>Masa dhe institucionet përgjegjëse janë të qartë.</p>	<p>Komisioni i Përkohshëm Parlamentar</p>		<p>Të papërbushur</p>
<p>2.1.6 Ngritja e rrjetit të komunikimit me operatorët mediatikë (online ose social) dhe bashkëpunimi me subjektet e angazhuar në verifikimin e vërtetësisë së informacionit</p>	<p>Masa duhet qartësuar. Institucioni përgjegjës është i qartë.</p>	<p>SSK 2024</p>		<p>Të papërbushur</p>
<p>2.1.7 Formimi i një bashkëpunimi për të promovuar bashkërregullimin dhe vetërregullimin në fushën e medias</p>	<p>Masa është e paqartë. Institucioni përgjegjës është i qartë.</p>	<p>SSK 2024</p>		<p>Të papërbushur</p>

Fusha 2: Ndërgjegjësimi publik mbi instrumentat e ndërhyrjeve dhe rritja e edukimit publik mbi dezinformimin

Kjo fushë përmban tre masa, të cilat janë ngushtësisht të ndërlidhura. Masa e parë parashikon hartimin e një strategjie kombëtare për edukimin mediatik dhe/ose integrimi i edukimit mediatik në arsimin e përgjithshëm (**Masa 2.2.1**); e dyta lidhet me hartimin e udhëzuesve/materialeve të informimit të gjerë publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin (**Masa 2.2.2**); ndërsa e treta me veprimtari me qëllim edukimin publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin (**Masa 2.2.3**). Afati për zbatimin e masës së parë është brenda vitit 2026, ndërsa për dy masat e tjera nuk ka një afat të përcaktuar.

Masa e parë dhe e tretë janë të pazbatuara, ndërsa e dyta është në zbatim e sipër. Duke qenë se institucioni përgjegjës për zbatimin e të tria masave është Struktura Përgjegjëse, do ishte e pritshme që të tria masat të ishin të pazbatuara. Mirëpo, duket se Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) është duke u marrë me zbatimin e kësaj mase, të cilën AMSHC-ja e ka parashikuar në planin e saj të punës për vitin 2025-2026.³ Në përgjigjen e saj ndaj kërkesës sonë për informacion, AMSHC-ja nuk shpjegoi arsyet për të cilat ajo ka ndërmarrë drejtimin e zbatimit të kësaj mase, duke qenë se nuk është ligjrisht institucioni përgjegjës. Gjithashtu e paqartë është mungesa e përfshirjes së ministrisë së Arsimit si një prej institucioneve përgjegjëse për zbatimin e masës së parë, që parashikon hartimin e Strategjisë Kombëtare për Edukimin Mediatik, veçanërisht nëse përfshihet një program për këtë qëllim në arsimin e përgjithshëm.

Masat janë në tërësi të ndërthurura me disa prej qëllimeve politike të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (2024) dhe Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, por janë të gjera e të paqarta në atë çka synojnë. Mënyra se si është shkruar masa e parë parashtron në fakt jo një masë por tre masa. Ajo e lë të mundsinë për (1) hartimin e një strategjie kombëtare për edukimin mediatik, (2) integrimin e edukimit mediatik në arsimin e përgjithshëm pa hartimin paraprak të strategjisë, si dhe (3) kryerjen e të dyjave. Për më tepër, nga një këndvështrim konceptual, duket kontradiktore që masa e parë të parashikojë hartimin e një strategjie për edukimin mediatik, ndërkohë që dy masat pasardhëse, të cilat do duhej të trajtoheshin si pjesë e strategjisë për edukimin mediatik, janë parashikuar pa nevojën për t'u shqyrtuar si pjesë e një strategjie të tillë. Rrjedhimisht, ose strategjia e edukimit mediatik është e panevojshme ose dy masat janë parashikuar para kohe.

³ Informacion i marrë nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në datën 7 janar 2026 në përgjigje të një kërkesë për informacion.

Tabela 3: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit II – Fusha 2

Masa	Qartësia	Harmonizimi	Zbatimi	Rezultatet e zbatimit
2.2.1 Hartimi i një strategjie kombëtare për edukimin mediatik dhe/ose integrimi i edukimit mediatik në arsimin e përgjithshëm	Masa është e paqartë. E paqartë gjithashtu mungesa e përfshirjes së ministrisë së Arsimit.	SSK 2024		Të papërbushur
2.2.2 Hartimi i udhëzuesve/ materialeve të informimit të gjerë publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin	Masa duhet qartësuar. Institucioni përgjegjës është i qartë.	SSK 2024		Përbushur pjesërisht. AMSHC-ja ka ndërmarrë hapat administrative për përbushjen e saj.
2.2.3 Veprimtari me qëllim edukimin publik mbi ndërhyrjet dhe dezinformimin	Masa duhet qartësuar. Institucioni përgjegjës për zbatimin e masës është i qartë.	SSK 2024		Të papërbushur

3.3.2 Objektivit III: Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe sektorëve të tjerë kritikë

Qëllimi kyç i objektivit është forcimi i kuadrit ligjor dhe praktikave institucionale për parandalimin e ndërhyrjeve të huaja keqdashëse në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare dhe nëpërmjet investimeve strategjike.

Nëpërmjet këtij objektivit, janë marrë një sërë zotimesh për hartimin e një kuadri rregullator për shqyrtimin e investimeve të huaja, promovimin e përdorimit të teknologjive të sigurta dhe furnizimin e infrastrukturës kritike nga furnitorë të sigurt. Këto zotime janë të përkthyer në masat e fushës së parë, “forcimi i mekanizmave ligjzbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonominë vendase”.

Përpos kësaj fushe, objektivi ka të përfshira disa masa nën fushën e dytë – “rritja e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit bankar në parandalimin e problematikave dhe informimin publik” – të cilat janë pjesë e Udhërrëfyesit të Strategjisë, por nuk janë përfshirë në pjesën e dokumentit strategjik ku trajtohen qëllimet e objektivave strategjike. Një sërë prej masave të këtij objektivi janë në zbatim e sipër, pavarësisht se ato janë duke u zbatuar në përputhje me masa institucionale ekzistuese dhe jo domosdoshmërisht për shkak të kërkesave të Strategjisë kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit (“Strategjia”).

Fusha 1: Forcimi i mekanizmave ligjzbatues për monitorimin dhe kontrollin e kapitaleve në ekonominë vendase

Kjo fushë përmban katër masa, tre prej të cilave janë në dobi të krijimit të një kuadri rregullator për verifikimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja. Ato përfshijnë hartimin e ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja, ngritjen e një sistemi monitorimi të investimeve në sektorët strategjikë, si dhe monitorimin dhe kufizimin e varësisë nga furnitorët e pasigurtë. Ndërkohë, masa e katërt synon krijimin e një njësie në nivel kombëtar për monitorimin e informacionit të rremë në sektorët kritikë/sistemin bankar dhe financiar (**Masa 3.1.4**). Ndonëse të katërta masat janë në zbatim e sipër, zbatimi po kryhet në përputhje me detyrime strategjike dhe institucionale që nuk i përgjigjen në thelb qëllimeve të Strategjisë.

Përsa i përket zbatimit të masës së parë dhe të dytë, një projektvendim i Këshillit të Ministrave i propozuar nga ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit – por jo ligj siç kërkohet nga Strategjia – përmban dispozita për monitorimin dhe shqyrtimin e investimeve të huaja. Qëllimi i projektvendimit është të rregullojë shqyrtimin e investimeve të huaja direkte të cilat prekin sektorët e ndjeshëm dhe strategjikë të ekonomisë shqiptare.

Projektvendimi është hartuar në përputhje me objektivat e Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027 që i referohen përmirësimit të qeverisjes ekonomike, nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe sigurimin e infrastrukturës digjitale.⁴ Ai synon përfshirjen në legjislacionin shqiptar të përcaktimeve të Rregullores 2019/452 të Bashkimit Evropian.⁵ Në bazë të Projektvendimit, ministria përgjegjëse për ekonominë duhet të kryejë verifikimet e investitorëve të huaj duke marrë informacionin e nevojshëm prej institucioneve të tjera kombëtare dhe prej institucioneve homologe të huaja përpara kryerjes së vlerësimit prej Komitetit Ndërmintor për Shqyrtimin e Investimeve

⁴ Relacion për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave për “Miratimin e Rregullores mbi Procedurat për Vlerësimin dhe Shqyrtimin e Investimeve të Huaja Direkte që Lidhen me ose Ndikojnë Infrastrukturën Publike Kritike, Teknologjinë Kritike dhe Mallrat me Përdorim të Dyfishtë, Furnizimin me të Dhëna Kritike, Qasjen në Informacion të Ndjeshëm apo për Lirinë e Medias,” <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/901>.

⁵ Relacion për Projektvendimin e Këshillit të Ministrave.

të Huaja Direkte, i cili kryesohet nga e njëjta ministri.⁶ Vlen për t'u theksuar se Projektvendimi parashikohet të zbatohet vetëm për investime në sektorin e qasjes ndaj informacionit dhe median. Ai nuk parashikohet të zbatohet për infrastrukturën kritike, teknologjinë kritike dhe mallrat me përdorim të dyfishtë, derisa Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.⁷

Përsa i përket masës së tretë, e cila i referohet monitorimit dhe kufizimit të varësisë nga furnitorët e pasigurtë, legjislacioni aktual për pronësinë përfituese dhe prokurimet në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes ka një sërë mekanizmash për monitorimin dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurtë. Dispozitat e legjislacioni për prokurimet në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes ndërlidhen me ato të informacionit të klasifikuar dhe sigurisë industriale për shkak të procedurave të verifikimit të operatorëve ekonomikë që përfshihen në procedura prokurimesh të klasifikuara.⁸ Një prej dispozitave më të rëndësishme të këtij legjislacioni, që ndihmon në procesin e gjurmimit dhe parandalimin e ndikimeve keqdashëse në sektorët strategjikë të vendit, është kushti që pronësia e operatorëve ekonomikë të jetë në “masën 51% dhe më lart në zotërim të individëve me shtetësi shqiptare...dhe jo më shumë se 5% në zotërim të individëve...[me] shtetësinë e një vendi jo anëtar të NATO-s, BE-së apo të një shteti tjetër [pa marrëveshje dypalëshe sigurie]”.⁹

Verifikimi i pronësisë bazohet në regjistrin e pronarëve përfitues që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Por pavarësisht ekzistencës së kuadrit ligjor për pronësinë fundore, ka mjaft boshllëqe rregullatore dhe institucionale për ta bërë atë të efektshëm në parandalimin e ndërhyrjeve të huaja keqdashëse në ekonominë shqiptare.¹⁰ Problemet e kuadrit ligjor për pronësinë përfituese dolën në pah edhe gjatë seancave dëgjimore të Komisionit të Posaçëm për të Koordinuar dhe për të Mbikëqyrur të Gjitha Veprimet Institucionale për të Luftuar Dezinformimin dhe Format e Tjera të Ndërhyrjes së Huaj në Proceset Demokratike të Vendit (“Komisioni i Posaçëm”).¹¹

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1088, datë 24.12.2020 “Për Përcaktimin e Mënyrës dhe të Procedurave të Regjistrimit e Publikimit të të Dhënave për Pronarët Përfitues, si dhe të Njoftimit nga

⁶ Shih nenet 5 dhe 6 të Projektvendimit, <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/901>.

⁷ Neni 19 i Projektvendimit.

⁸ Shih Ligjin Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë,” <https://www.mod.gov.al/images/akteligjore/prokurimet/ligj-2020-04-16-36.pdf>; Vendimin i Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 23.10.2024 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë industriale, rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/23/659>; Ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar,” <https://tinyurl.com/mzbpjh34>.

⁹ Neni 14, pika 1 (gj) e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 659, datë 23.10.2024.

¹⁰ Ligji Nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues,” <https://qbz.gov.al/preview/caaa4106-aab1-44bb-a34b-1ada78851423/cons/20220216>; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1088, datë 24.12.2020 “Për Përcaktimin e Mënyrës dhe të Procedurave të Regjistrimit e Publikimit të të Dhënave për Pronarët Përfitues, si dhe të Njoftimit nga Autoritetet Shtetërore Kompetente e nga Subjektet e Detyruara,” <https://tinyurl.com/yjw9etjf>.

¹¹ Diskutimet rreth këtyre problematikave u zhvilluan veçanërisht gjatë seancave dëgjimore me përfaqësuesit e Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Shih procesverbalet e Komisionit të Posaçëm të datëve 23 tetor 2024 dhe 6 nëntor 2024. Procesverbalet gjenden në adresën e Komisionit të Posaçëm, <https://www.parlament.al/struktura/8e230ff7-5344-45fb-bd6c-510f927c6b92>.

Autoritetet Shtetërore Kompetente e nga Subjektet e Detyruara” përmban rregullat e detajuara për regjistrimin e pronarëve përfitues. Ky vendim detyron pronarë që kanë pronësi të paktën 25 për qind të një subjekti për t’u deklaruar. Mirëpo përmban një dispozitë që e përjashton personin përgjegjës për regjistrimin e pronarëve përfitues të një operatori ekonomik, si dhe edhe vetë operatorin ekonomik, nga përgjegjësia që me patjetër të identifikojë pronarin përfitues.

Pika 1 (d), seksioni III i Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 1088 parashikon se “Në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë sipronar përfitues individin, i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25 (njëzet e pesë) % ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues, sipas përcaktimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues, atëherë subjektet raportuese duhet të identifikojnë e të regjistrojnë...individin që: i. përcakton vendimet e marra nga një person juridik; ii. kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të personit juridik.” Kjo dispozitë e cënon qëllimin e shprehur të legjislacionit duke mundësuar hapësira të gjera për mosdeklarimin e pronarit përfitues, sidomos në ato raste kur pronësia mund të mbahet zyrtarisht prej një subjekti ekonomik që është kompani guaskë ose trust, pronarët e të cilit janë ligjërisht të fshehur. Duke qenë se qëllimi në thelb i kësaj VKM-je është regjistrimi dhe jo zbulimi i pronarit përfitues, ajo nuk përmban dispozita për koordinimin ndër-institucional të institucioneve përgjegjëse për të arritur këtë qëllim, pavarësisht se u është mundësuar qasja ndaj regjistrit që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.¹²

Ndërkohë, përsa i përket masës për ngritjes së njësisë kombtare për monitorimin e lajmeve të rreme në sektorët kritikë/sectorin bankar e financiar, sipas Bankës së Shqipërisë ky funksion kryhet prej Zyrës së Shtypit të saj, e cila është duke planifikuar aftësimin e mëtejshëm të kësaj njësie për të parandaluar dhe për t’iu kundërpërgjigjur përhapjes së lajmeve të rreme në sektorin financiar.¹³ Ndonëse Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase, sektorët kritikë nuk mund të kufizohen vetëm te sektori bankar dhe financiar. Mirëpo kjo masë nuk ka të përfshira veprimet specifike që duhen marrë për përmbushjen e saj e rrjedhimisht është e paqartë arsyeja për të cilën Banka e Shqipërisë duke të jetë institucioni përgjegjës.

Paqartësia e masës së katërt nuk është e vetmja brenda kësaj fushe. Është po ashtu e paqartë se çfarë synohet të arrihet nëpërmjet masës së dytë, për “zbatimin e një sistemi transparent për monitorimin e investimeve në sektorët strategjikë”, duke qenë se veprimet specifike për zbatimin e masës i referohen ruajtjes së balancave “ndërmjet ndikimit të ekzekutivit duke përfshirë autoritetin e grupeve të interesit, si komuniteti i biznesit, në procesin e vendimmarrjes” për hartimin e ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja. Nëse qëllimi është që komuniteti i biznesit të jetë i përfshirë dhe

¹² Qasja ndaj regjistrit të pronarëve përfitues i është mundësuar Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Shih Sekioni V, pika 2 e Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1088.

¹³ Informacion i marrë nga Banka e Shqipërisë në datën 16 janar 2026 në përgjigje të një kërkesë për informacion.

i informuar për sistemin e monitorimit në mënyrë që të ketë qartësinë e nevojshme rregulatore, kjo çështje mund të trajtohet nëpërmjet praktikave ekzistuese ligjore për konsultimet publike.

Ndërkohë, masa e tretë, që trajton monitorimin dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurt, nuk ka të shtjelluara veprimet specifike që duhen marrë për realizimin e saj dhe dy institucionet kyçe përgjegjëse – komisioni i përhershëm parlamentar dhe Struktura Përgjegjëse – nuk ekzistojnë.

Tabela 4: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit III – Fusha 1

Masa	Qëllimi	Harmonizimi	Zbatimi	Rezultatet e zbatimit
3.1.1 Miratimi i ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja	Masa është e qartë. Është e paqartë ndarja e përgjegjësive institucionale.	Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027		Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka propozuar një vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) që duhet të rregullojë verifikimin e investimeve të huaja. Fushëveprimi i VKM-së përfshin vetëm investimet në sektorin e informacionit dhe median deri në anëtarësimin e Shqipërisë në BE.
3.1.2 Zbatimi i një sistemi transparent për monitorimin e investimeve në sektorët strategjikë	Masa është e paqartë. Nuk ka institucione përgjegjëse të përcaktuara.	Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027		Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit ka propozuar një vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) që duhet të rregullojë verifikimin e investimeve të huaja. Fushëveprimi i VKM-së përfshin vetëm investimet në sektorin e informacionit dhe median deri në anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

3.1.3 Monitorim dhe kufizim i varësisë nga furnitorë të pasigurtë	Masa dhe përgjegjësitë institucionale janë të paqarta.	E ndërlidhur me legjislacionin për pronësinë përfituese dhe prokurimet në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes.		Legjislacioni aktual për pronësinë përfituese dhe prokurimet në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes ka një sërë mekanizmash për monitorimin dhe kufizimin e varësisë nga furnitorë të pasigurtë.
3.1.4 Krijimi i një njësie të specializuar në nivel kombëtar për monitorimin e informacionit të rremë në sektorë kritikë/ sistemin bankar dhe financiar	Masa dhe përgjegjësitë institucionale duhen qartësuar.	SSK 2024		Të papërbushura. Zyra e Shtypit e Bankës së Shqipërisë është përgjegjëse për sistemin bankar e financiar.

Fusha 2: Rritja e komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit bankar në parandalimin e problematikave dhe informimin publik

Kjo fushë ka dy masa. Masa e parë, që synon rritjen e komunikimit midis sektorit privat dhe atij publik për të shqyrtuar ekspozimin dhe vulnerabilitetin e ekonomisë kombëtare ndaj ndërhyrjeve të huaja keqdashëse, është e pazbatuar. Për më tepër, nuk është e qartë se cili është synimi i saj. Në shtjellimin e veprimeve për realizimin e saj parashikohet zhvillimi i një forumi për diskutimin e gjendjes së tregjeve dhe vulnerabilitetit të ekonomisë, por nuk përcaktohet se cili duhet të jetë rezultati i këtij forumi, që është parashikuar të ndodhë çdo një vit. Ndërkohë, institucioni kryesor për zbatimin e saj është Struktura Përgjegjëse, e cila ende nuk është ngritur.

Masa e dytë, që synon rritjen e transparencës ndaj publikut për gjendjen e investimeve të huaja në Shqipëri, është në zbatim e sipër. Ashtu si në rastet në zbatim në fushën e mëparshme, edhe kjo

masë vlerësohet në zbatim për shkak të veprimeve të marra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të publikimit të statistikave mbi investimet e huaja direkte dhe të dhënat mbi pronësinë e institucioneve financiare bankare dhe jo bankare të licencuara prej saj. Banka publikon statistika mbi flukset e investimeve të huaja direkte mbi baza tre-mujore, mirëpo të dhënat statistikore nuk janë të ndara në bazë të sektorëve ekonomikë.¹⁴

Pavarësisht se këto informacione janë të vlefshme dhe përmbushin pjesërisht kërkesat e masës, ato janë të pamjaftueshme. Në bazë të masës, institucionet përgjegjëse – të cilat përfshijnë Strukturën Përgjegjëse, ministritë përgjegjëse për financat dhe ekonominë, si dhe Bankën e Shqipërisë – duhet të hartojnë një metodologji dhe formate raportimi tërësore për secilin prej sektorëve të ekonomisë shqiptare, jo vetëm sektorin bankar e financiar.

Tabela 5: Vlerësimi i masave në kuadër të Objektivit III – Fusha 2

Masa	Qartësia	Harmonizimi	Zbatimi	Rezultatet e zbatimit
3.2.1 Forcimi i ndërveprimit dhe komunikimit të sektorit privat me institucionet publike	Masa dhe përgjegjësitë institucionale duhen qartësuar.	SSK 2024		Të papërmbyshura
3.2.2 Informimi publik mbi gjendjen e ekonomisë vendase në raport me kapitalet dhe investimet e huaja	Masa dhe përgjegjësitë institucionale duhen qartësuar.	SSK 2024		Mungon një metodologji dhe format raportimi tërësor për secilin prej sektorëve të ekonomisë shqiptare. Megjithatë, Banka e Shqipërisë publikon statistika mbi investimet e huaja.

¹⁴ Statistikat për investimet e huaja direkte mund të gjenden në https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Investimet_e_huaja_direkte/. Të dhënat e pronësisë për subjektet e licencuara mund të gjenden në https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/.

4. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME



Gjetjet e monitorimit të periudhës korrik 2025 – janar 2026 tregojnë se zbatimi i masave të parashikuara në kuadër të Objektivave II dhe III të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030 mbetet në një fazë fillestare dhe karakterizohet nga progres i kufizuar në nivel strukturor dhe normativ.

Nga 16 masat e analizuara në këta dy objektiva, asnjë nuk rezulton e zbatuar plotësisht, ndërsa shumica e tyre mbeten në faza paraprake planifikimi ose nuk kanë hyrë ende në zbatim. Progresi i deritanishëm lidhet kryesisht me elementë të koordinimit institucional dhe përgatitjes së ndërhyrjeve të ardhshme ligjore dhe rregullatore, ndërsa masat që kërkojnë krijimin e strukturave të dedikuara, miratimin e kuadrit ligjor për ndërhyrjet e huaja hibride dhe vendosjen e mekanizmave të mbrojtjes së sektorëve strategjikë mbeten ende të pazhvilluara.

Një faktor përcaktues për ritmin e kufizuar të zbatimit lidhet me mungesën e miratimit të Planit të Veprimit dhe moskrijimin e Strukturës Përgjegjëse të parashikuar nga Strategjia, e cila pritet të luajë rol koordinues në zbatimin e një pjese të konsiderueshme të masave në kuadër të Objektivave II dhe III. Në mungesë të këtyre mekanizmave, shpërndarja e përgjegjësive ndërinstitucionale mbetet pjesërisht e paqartë dhe rrezikon të prodhojë fragmentim në zbatimin e politikave për adresimin e ndërhyrjeve hibride dhe mbrojtjen e sektorëve strategjikë të ekonomisë.

Në mënyrë të veçantë, masat që lidhen me krijimin e kuadrit ligjor për ndërhyrjet e huaja, shqyrtimin e investimeve strategjike, forcimin e sigurisë së zinxhirëve të furnizimit dhe rritjen e transparencës mbi pronësinë përfituese mbeten thelbësore për ndërtimin e një arkitekture funksionale të reziliencës kombëtare ndaj ndikimeve keqdashëse.

Në tërësi, gjetjet e këtij monitorimi tregojnë se progresi i vitit të parë të zbatimit të Strategjisë do të varet në mënyrë vendimtare nga krijimi i mekanizmave koordinues qendrorë dhe nga zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregullator që mbështet zbatimin e masave të parashikuara në këta dy objektiva.

Gjatë vitit të parë të zbatimit të Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit 2025–2030, prioriteti kryesor duhet të jetë krijimi i bazës institucionale dhe ligjore që mundëson kalimin nga masa programatike në masa operationale në kuadër të Objektivave II dhe III.

Rekomandime për Objektivin II:

Në radhë të parë, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave duhet të prioritetizojnë hartimin dhe miratimin e kuadrit ligjor për ndërhyrjet e huaja dhe dezinformimin, si dhe krijimin e Strukturës Përgjegjëse të parashikuar nga Strategjia. Ky kuadër duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë përgjegjësitë institucionale, mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional dhe instrumentet për identifikimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve hibride në nivel kombëtar.

Në funksion të garantimit të vazhdimësisë së mbikëqyrjes institucionale, Kuvendi i Shqipërisë duhet të shqyrtojë krijimin e një mekanizmi të përhershëm parlamentar për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë dhe legjisllacionit për ndërhyrjet e huaja keqdashëse dhe dezinformimin, qoftë përmes ngritjes së një komisioni të posaçëm, qoftë përmes delegimit të këtij funksioni në një nënkomision të specializuar në kuadër të Komisionit për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen.

Në fushën e bashkëpunimit me median dhe aktorët e verifikimit të fakteve, është e nevojshme që masat e parashikuara në Strategji të qartësohen më tej në aspektin konceptual dhe rregullator, në mënyrë që të shmangen interpretimet që mund të krijojnë rrezik për ndërhyrje në lirinë e shprehjes. Në këtë drejtim, duhet të përcaktohen qartë rolet institucionale dhe kufijtë e ndërhyrjes publike në raport me mekanizmat e vetërregullimit dhe bashkërregullimit.

Paralelisht, hartimi i një strategjie të dedikuar për edukimin mediatik dhe informativ do të përbente një hap të rëndësishëm për operacionalizimin e masave parandaluese të Strategjisë. Ky proces duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet përgjegjëse për politikën digjitale dhe të komunikimit publik, duke u mbështetur në një vlerësim të strukturuar të risqeve dhe nevojave në nivel kombëtar.

Rekomandime për Objektivin III:

Në kuadër të forcimit të mbrojtjes së sektorëve strategjikë të ekonomisë, është i nevojshëm avancimi i kuadrit ligjor për shqyrtimin e investimeve të huaja në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me Rregulloren (BE) 2019/452 për kontrollin e investimeve të huaja direkte. Ky kuadër duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë sektorët strategjikë, mekanizmat e shqyrtimit të investimeve dhe përgjegjësitë institucionale për monitorimin e tyre.

Gjithashtu, rekomandohet zhvillimi i kornizave rregullatore për forcimin e sigurisë së zinxhirëve të furnizimit në sektorë kritikë si energjia, transporti, shëndetësia, teknologjia e informacionit dhe inteligjenca artificiale. Këto korniza duhet të adresojnë jo vetëm investimet e huaja direkte, por edhe marrëdhëniet tregtare dhe varësitë strukturore ndërmjet operatorëve vendas dhe atyre ndërkombëtarë në sektorët me rëndësi strategjike.

Forcimi i transparencës mbi pronësinë përfituese të subjekteve tregtare mbetet një element thelbësor për parandalimin e ndërhyrjeve keqdashëse në ekonominë kombëtare. Në këtë drejtim, është i nevojshëm rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe forcimi i mekanizmave institucionalë për identifikimin, verifikimin dhe analizimin e strukturave komplekse të pronësisë përfituese, veçanërisht në sektorët me risk të lartë strategjik.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve për identifikimin e ndërhyrjeve përmes manipulimit të informacionit në sektorët ekonomikë dhe financiarë, është e nevojshme të përcaktohet qartë fusha e zbatimit dhe vendosja institucionale e njësisë së parashikuar për monitorimin e dezinformimit në sektorët kritikë, duke sqaruar raportin e saj me Strukturën Përgjegjëse dhe me institucionet rregullatore ekzistuese.

Së fundi, rekomandohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat përmes mekanizmave të strukturuar të shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit strategjik, si dhe zhvillimi i metodologjive të standardizuara për raportimin publik të investimeve dhe flukseve financiare strategjike, me qëllim rritjen e transparencës dhe përmirësimin e monitorimit të risqeve që lidhen me ndërhyrjet e huaja në ekonomi.



Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Ndërhyrjeve të Huaja dhe Dezinformimit:

Siguria kombëtare, ekonomia
dhe sektorët kritikë

Vlerësim për Objektivat II dhe III në 6 muajt e parë të zbatimit

